



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	26.05.2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojçja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMS/SHK	2657/2021		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.306/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shaban anëtarë, me Valentina Kaçandolli Bektashi Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.306/2021 të datës 27.04.2021 të parashtruar nga ankuesi Rruga "Borshi", Mati 1, Nr.16 Prishtinë, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 26/05/2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Shfuqizohet** Vendimi me numër të referencës 84/2021 i datës 07.04.2021 i zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
- II. Obligohet** Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, t'i ndër marr të gjitha veprimet procedurale ligjore për rishqyrtimin e kërkesës/lëndës së ankuesit në pajtim me rekomandimet e këtij vendimi.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me pikën II të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas Akt emërimit me numër 092 të datës 21.12.2013 është i sistemuar në vendin e punës "Udhëheqës i Departamentit për Evropë dhe BE", ndërsa me datë 21.11.2016 Ministri i Punëve të Jashtme nxjerr vendimin me numër të referencës 651/2016 me të cilin vendim ankuesi ngritët në detyrë nga Grada Këshilltar në Gradën Diplomate Ministër Këshilltar.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës me datë 18.12.2020 nxjerr vendimin me numër të referencës 1034/2020 me të cilin Vendim ankuesi me Gradë Diplomatike "Ministër Këshilltar" në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Bruksel/Belgjikë, pas përfundimit të mandatit të tij tërhiqet/kthehet nga Misioni në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme me datë 30.12.2020 nxjerr vendimin me numër të referencës 251/2020, ku ankuesi pas kthimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme me Gradën Diplomatike Ministër Këshilltar, i cili ka shërbyer në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Bruksel/Belgjikë, sistemohet në pozitën "Zyrtarë i Lartë për Organizatat Ndërkombëtare"-Departamenti për Organizatat Ndërkombëtare.

Ankuesi me datë 12.01.2021 nëpërmjet e-mail-it zyrtarë i'a konfirmon Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Diasporës pranimin e vendimit për sistemim të përkohshëm, edhe pse ankuesi e ka konsideruar se vendimi nuk është në harmoni me pozitën paraprake, eksperiencën e tij të punës menagjeriale, vlerësimin e punës e të tjera.

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 07.04.2021 nxjerr vendimin me numër të referencës 84/2021 me të cilin vendim ankuesi nga pozita "Zyrtar i Lartë për Organizatat Ndërkombëtare" caktohet "Zëvendësues i Udhëheqësit të Departamentit për Çështje Rajonale".

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin me numër të referencës 84/2021 të datës 07.04.2021 të Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Diasporës me datë 27.04.2021 parashtron ankesën me numër të protokollit 2018/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.05.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës të cilën kërkesë Ministria e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës e ka pranuar me datë 07.05.2021. Më datë 11.05.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/8.

Kolegji për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike , ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 27.04.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimi i ankuesit i datës 20.12.2013; Vendimi i datës 21.11.2016 me numër të referencës 651/2016 i Ministrit të Punëve të Jashtme; Vendimi i datës 07.04.2021 me numër të referencës 84/2021 i Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimi i datës 31.12.2020 me numër të referencës 251/2020 i Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; E-mail i datave 11.01.2021, 12.01.2021 si dhe i datës 13.01.2021; Vendimi i datës 18.12.2020 me numër të referencës 1034/2020 i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; E-mail i datës 19.05.2021 i Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruar nga palët, ka konstatuar se është plotësuar kërkesa ligjore që lënda e ankuesit të kthehet në *rishqyrtim*, duke e obliguar Zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për ti ndërmarrë të gjitha veprimet për ta rishqyrtuar kërkesën/lëndën e ankuesit konformë pikës II të këtij vendimi.

Bazuar në provat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me datë 07.04.2021 ka nxjerr vendimin me numër të referencës 84/2021 me të cilin vendim ankuesir ka caktuar në vendin e punës "Zëvendësues i Udhëheqësit të Departamentit për Çështje Rajonale", i cili vendim nuk i përmban elementet e përcaktuara të aktit administrativ ashtu siç janë përcaktuar me dispozitat ligjore të nenit 47 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse vendimi nuk përmban një përmbledhje faktike mbi bazën e së cilën është marrë vendimi me numër të referencës 84/2021 të datës 07.04.2021 i Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm, po ashtu ky vendim nuk është i arsyetuar ashtu siç duhet sepse arsyetimi i vendimit duhet të formulohet i qartë dhe të përfshijë shpjegimin e bazës ligjore dhe faktike të aktit, në arsyetimin e vendimit të lartë cekur nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që e kanë kushtëzuar marrjen e vendimit, po ashtu Kolegji ka konstatuar se vendimi i Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm nuk e përmban pjesën përmbyllëse që ka të bëjë me këshillën juridike që ndaj këtij vendimi pala ku ka të drejtë të parashtrorj ankesë.

Duke marr parasysh dispozitat e lartcekura, Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton që në rastin e shqyrtimit të ankesës së ankuesit kemi edhe shkelje të dispozitave të nenit 52 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 dhe të paragrafit 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku është përcaktuar se "**1.Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1.kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve**", që paragrafi 6 i po këtij neni ka përcaktuar se: "**Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme**", rrjedhimisht Kolegji ka konstatuar se Vendimi me numër të referencës 84/2021 i datës 07.04.2021 i Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Diasporës nuk e ka paraparë afatin se nga cila datë fillon dhe mbaron ankuesi në ushtrimin e detyrave të punës në pozitën "Zëvendës i Udhëheqësit të Departamentit për Çështje Rajonale".

Andaj bazuar në këto dispozita ligjore, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerësoi që lënda e ankuesit të kthehet në rishqyrtim dhe se organi i punësimit me rastin e rishqyrtimit të lëndës ti këtë parasysh dispozitat e legjislacionit që rregullojnë shërbimin civil si dhe të gjeturat e konstatuara sipas këtij vendimi.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjithave shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.306/2021, datë 26/05/2021

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet;

- Ankuesit
- Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqëses së Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-s

